



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA VIII
Sesioni pranveror

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis, Planifikim Hapësinor dhe Infrastrukturë
Mbledhja nr. 15
Prishtinë, më 19.7.2021, në orën 12:30
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Fitore Pacolli-Dalipi, Milazim Salijaj, Ekrem Mustafa, Arbëreshë Kryeziu- Hyseni, Salih Zyba, Samra Ilijazi dhe Albena Reshitaj.

Munguan: Zoran Mojsilović, Fadil Nura, Bekim Haxhiu dhe Besian Mustafa.

Pjesëmarrës të tjerë: Edolind Bytyçi, praktikant, Shqipe Shala, këshilltare ligjore.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku dhe Ylber Sherifi.

Mbledhjen e kryesoi, **Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare e Komisionit.**

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 13.7.2021;
3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 05/L-132 për Automjete;
4. Të ndryshme.

Kryetarja konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua me 7 vota për.

2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e mbajtur më 13.7.2021

Komisioni e miratoi procesverbalin me 7 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim.

3. Shqyrtimi i Projektligjit nr.08/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit 05/L-132 për Automjete

Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare, tha se diskutimet për projektligjin kanë përfunduar dhe pasi që projektligji me amendamente u është dërguar komisioneve të përhershme, ai është shqyrtuar dhe përkrahur nga tre komisione, ndërsa Komisioni për Komunitete nuk e ka përkrahur, prandaj komisioni do ta procedojë për seancë plenare.

Albena Reshitaj, tha se në mbledhjen e kaluar ka diskutuar për projektligjin, por nuk do të marrë pjesë në votim, pasi që asnjë deputet nga opozita nuk po merr pjesë në mbledhje.

Kryetarja, ftoi deputetët për votim dhe konstatoi se komisioni, me 6 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim, vendosi që Kuvendit t'ia paraqes Raportin me rekomandime, lidhur me Projektligjin 08/L-004 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-132 për Automjete.

9. Të ndryshme

Fitore Pacolli-Dalipi, kryetare, në lidhje me dërgimin propozimeve për ekspertë, tha se ka kohë edhe sot dhe ftoi që t'i dërgojnë propozimet nëse kanë.

Salih Zyba, pyeti në lidhje me grupet punuese, kurse stafi u përgjigj se vendimet për themelimin e 4 grupeve punuese janë të nënshkruara nga kryetarja si dhe janë përgatitur edhe draft-planet për mbikëqyrje.

Mbledhja përfundoi në orën 12:50.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Fitore Pacolli-Dalipi.

Kryetare e Komisionit